VENDIM
Nr.20, datë 14.2.2008

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR PËRDORUESIT E SISTEMIT TË SHPËRNDARJES, PËR PERIUDHËN 1 MARS 2008 – 28 SHKURT 2009

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, germa "b", 9, 26, pika 1, 27, dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.29, datë 24.6.2005 "Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 14.2.2008, pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria KESH sh.a. (OSSH sh.a.) për miratimin e tarifës së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike për përdoruesit e sistemit të shpërndarjes,

VENDOSI:

1. Tarifa e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike për përdoruesit e sistemit të shpërndarjes, për periudhën 1 mars 2008 – 28 shkurt 2009, është:

- 2.00 lekë /kWh për përdoruesit e sistemit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV;
- 2.60 lekë /kWh për përdoruesit e sistemit të shpërndarjes në nivelet e tensionit 20/10/6 kV;

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i Ere-s
Bujar Nepravishta